

Ekskluzive

I gjakosur strehohet në një shtëpi në Obiliq, Policia gjen karikator të AK-47 dhe fishekë



Sinjali.com

24 Qershor 2026 10:35



Një rast i pazakontë është raportuar në Obiliq, ku një person i lënduar dyshohet se është strehuar në një shtëpi, pasi kishte kërcyer nga një veturë për t’iu shmangur disa personave ende të panjohur, mëson ekskluzivisht Gazeta Sinjali.

Sipas burimeve të Sinjalit, rasti ka ndodhur më 23 qershor, rreth orës 22:05, në rrugën “Viktoria”, në fshatin Mazgit.

Burimet bëjnë të ditur se Policia është njoftuar për një person të gjakosur, i cili ishte strehuar në shtëpinë e një banori të zonës.

I dyshuari F.R., pas marrjes së tretmanit mjekësor në QKUK, është shoqëruar për intervistim në Stacionin Policor në Obiliq.

Gjatë intervistimit, ai dyshohet se ka deklaruar se pas një mosmarrëveshjeje me disa persona, i është shmangur rrezikut duke kërcyer nga vetura e të dyshuarve, për momentin të panjohur.

Më pas, i njëjti dyshohet se është strehuar në një shtëpi afër, duke hapur me forcë dyert e objektit dhe duke shkaktuar dëme materiale.

Në vendin e ngjarjes, Policia ka gjetur një karikator të AK-47 dhe 15 fishekë të kalibrit 7.62 mm, të cilët dyshohet se i kishte me vete i dyshuari.

Pas konsultimit me Prokurorin kompetent, rasti është iniciuar për veprat penale **“Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”, “Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Lëndim i lehtë trupor”**.

Rasti do të vazhdojë në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet janë në vazhdim.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera